



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

RAPORT PËRMBLEDHËS I QENDRËS SË KOORDINIMIT
KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
JANAR - QERSHOR
2025



HYRJE

Ky raport ka për qëllim të pasqyrojë aktivitetin 6-mujor, janar - qershor 2025 të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim QKEDH) dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në detyrimet që rrjedhin nga VKM nr.737/2017 “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, i ndryshuar, VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, VKM nr. 81, datë 14.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025” dhe të planeve të veprimit 2023-2025”.

1. FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE KOMUNITETEVE PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, QKEDH ka vijuar intensivisht punën për zbatimin e angazhimeve të saj në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023-2025, si edhe të Planit të Veprimit të përcaktuar për periudhën respektive. Fokusi kryesor ka qenë ngritja e kapaciteteve në institucionet qendrore dhe vendore për të adresuar fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe monitorimi i proceseve të Rehabilitimit, Risocializimit dhe Riintegritit.

Ndërhyrjet kryesore të realizuara përfshijnë:

- Fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, me institucione ligj-zbatuese dhe aktorë të tjerë, për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- Fuqizimin e mekanizmave të referimit për shkëmbimin e informacionit ndërmjet aktorëve institucionale dhe strukturave të përfshira si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e radikalizmit;
- Rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike përmes trajnimeve mbi identifikimin dhe referimin e shenjave të hershme të radikalizmit;
- Fuqizimin e kapaciteteve për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit;
- Mbështetjen ekonomike të familjeve të prekura, nëpërmjet përfshirjes në programe punësimi dhe kurse kualifikimi për ngritje kapacitetesh.
- Të gjitha këto ndërhyrje janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që veprojnë në fushën e P/KEDH.

Fuqizimi i Komiteteve Rajonale

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 185/2023, QKEDH ka vijuar me fuqizimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, përmes ndjekjes së 16 takimeve të Komiteteve Rajonale në të 12 qarqet e vendit; Organizimi i 15 sesioneve trajnimi për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Sekretariateve të tyre Teknike; si dhe Raportime tremujore drejtuar Koordinatorit Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;

Trajnimi i punonjësve të strukturave ligj-zbatuese

Gjatë kësaj periudhe, QKEDH ka koordinuar trajnimin e 413 punonjësve të Policisë së Shtetit, përfshirë: Oficerë të Patrullës së Përgjithshme (OPP), Specialistë të Policisë në Zonë (SPZ), dhe Punonjës të Policisë Kufitare.

Në kuadër të projektit CIVIPOL për Mbrojtjen e Hapësirave Publike, janë organizuar 2 trajnime rajonale me pjesëmarrjen e 10 oficerëve të lartë të Policisë së Shtetit, së bashku me kolegë nga vende të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Trajnime për aktorët e vijës së parë

Përmes bashkëpunimit me OSHC-të janë zhvilluar 7-trajnime të aktorëve të vijës së parë (punonjës të qendrave komunitare, punonjës social, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, oficerëve të sigurisë në shkolla, mësuesve dhe psikologëve).

Gjithashtu janë zhvilluar edhe takime ndërinstitucionale mbi ecurinë e proceseve RRR në ambientet e reja të Qendrës Multifunksionale Kombinat, me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse dhe OSHC-të.

Nisma për mbështetjen e të kthyerve nga zonat e konfliktit

Me qëllim fuqizimin ekonomik të grave të kthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak, në kuadër të ciklit të trajnimeve mbi zhvillimin e aftësive artizanale të organizuar nga GADC, 5 (pesë) gra kanë përfituar kurse profesionale për punime artizanale dhe makrame.

Pas përfundimit të trajnimeve; 4 nga gratë e kthyer kanë përfunduar kursin e makrame; kanë ndjekur trajnime për punime artizanale si dhe kanë hapur faqet e tyre në Instagram për promovimin dhe shitjen e produkteve. Një nga gratë ka kryer kursin për ndihmës ekonomiste dhe ka punuar si asistente në një biznes këshillimi financiar deri në qershor 2025. Ky proces ka kontribuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe fillimin e integritit ekonomik të këtyre grave.

Bashkëpunime me institucionet akademike

QKEDH në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i

Tiranës ka zhvilluar disa aktivitete duke përfshirë *workshope* me studentët, vizita studimore pranë ambienteve të QKEDH-së si dhe njohja me raste studimore konkrete për të adresuar çështjet e P/KEDH.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi në komunitet

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar trajnime mbi të drejtat e njeriut dhe tolerancën fetare me pjesëmarrjen e 189 nxënësve të sistemit para universitar dhe të rinjve në qytetet Cërrik, Kavajë, Fier dhe Pogradec. Gjithashtu janë zhvilluar 6 sesione online dhe 3 aktivitete fizike me 25 përfaqësues të komuniteteve fetare, me fokus shpërndarjen e mesazheve të tolerancës.

Fugizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike

QKEDH ka vijuar me një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse dhe trajnimesh për forcimin e rolit të KVSP-ve në 5 bashki: (Cërrik, Pogradec, Librazhd, Elbasan dhe Korçë), të fokusuar në zbërthimin e metodologjisë së performancës së KVSP-ve, dhe hartimin e Planit të Veprimit për KVSP-të.

QKEDH si Pikë Fokale për Projektin Evropian

QKEDH në rolin e saj si pikë fokale për projektin evropian “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga CIVIPOL, ka koordinuar:

- Seminarin Rajonal “Metodat e zbulimit, identifikimit dhe neutralizimit të UAS (sistemi i avionëve pa pilot/dronë), si dhe përdorimin e UAS për mbrojtjen e hapësirave publike”, me pjesëmarrjen e 4 përfaqësuesve të DPPSH.
- Seminarin Rajonal “Trajnimi i aktorëve kryesorë për hartimin e Planit të Qëndrueshmërisë dhe mbi masat teknike, të sigurisë për të siguruar qëndrueshmërinë e entiteteve kritike”, me pjesëmarrjen e 4 përfaqësuesve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- Takimin e 4-të të Bordit Drejtues të projektit evropian “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor” zbatuar nga CIVIPOL, mbajtur në Tiranë me përfaqësues nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues të autoriteteve Franceze, Kroate, Italiane dhe Greke.
- Trajnimin me temë “Demonstrim Rajonal i risive të fundit për të siguruar evente në shkallë të madhe, përfshirë strategjitë C-UAV, përdorimi i skuadrës për çarmatimin e bombave dhe ekspertëve CBRN si dhe trajnim i qenve të policisë”.

2. PROCESI I REHABILITIMIT / RIINTEGRIMIT / RISOCIALIZIMIT PËR PERSONAT E KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT SIRI / IRAK

QKEDH si institucioni kryesor për zhvillimin e politikave dhe koordinimin në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe ndjekjen e proceseve të rehabilitim-riintegrim dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri-Irak, vepron në bazë të VKM (konfidenciale) Nr. 453 datë 29.07 2021 si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025 si më poshtë:

Shteti shqiptar ka kryer 4 operacione riatdhesimi, ku ka kthyer **38 (tridhjetë e tetë)** shtetas shqiptarë nga zonat e konfliktit Siri-Irak, konkretisht **1(një)** shtetas në vitin 2019 (i cili nuk ndiqet nga QKEDH), **13 (trembëdhjetë)** shtetas shqiptarë që u riatdhesuan më datë **27 maj 2022**, **19 (nëntëmbëdhjetë)** shtetas shqiptarë të riatdhesuar më datën **1 gusht 2021** dhe **5 (pesë)** shtetas të riatdhesuar në **27 tetor 2020**.

QKEDH vijon angazhimin maksimal për koordinimin dhe monitorimin e punës me ministritë e linjës, agjencitë ligj-zbatuese, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të lehtësuar procesin e Rehabilitimit, Risocializimit dhe Riintegritimit (RRR) në komunitet të **37 (tridhjetë e shtatë)** shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga zonat e konflikti Siri-Irak, nga të cilët **36 (tridhjetë e gjashtë)** të riatdhesuar janë të vendosur në territorin e Bashkisë Tiranë dhe 1 rast në Bashkinë Librazhd.


QKEDH ndjek dhe monitoron procesin e Rehabilitimit / Risocializimit dhe Riintegritimit (RRR) në nivel qendror dhe vendor duke u fokusuar në zbatimin e Planeve Individuale të Mbrojtjes zhvilluar për secilin person nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës për fëmijët dhe Punonjësi Social / menaxheri rastit i Njësive Administrative ku janë vendosur familjet me banim. Në përmbushje të këtij funksioni, QKEDH merr në shqyrtim raportime periodike vlerësuese mbi ecurinë e procesit nga psikologë, teologë, zyra vendore arsimore dhe Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Gjithashtu është pjesë e të gjitha takimeve të Grupeve Teknike Ndërsektoriale ku vlerësohet Plani Individual i Mbrojtjes për secilin rast dhe koordinohet e ndiqet në një linjë me PMF-të.

Aktualisht QKEDH ndjek **37 (tridhjetë e shtatë)** Plane Individuale Mbrojtje të cilat rishqyrtohen nga Grupet Teknike Ndërsektoriale, për secilin individ në mënyrë periodike çdo 3 muaj, për të identifikuar nevojat dhe vlerësuar ecurinë në procesin e riintegritimit.

Gjatë këtij gjashtëmujori, QKEDH ka forcuar strukturat dhe bashkëpunimin ndërinstitutional në fushën e parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

PIESËMARRËS NË TAKIME/TRAJNIME/SEANCA INFORMUESE



- Trajnime OPP - SCPA (Programi Suedezi)
- Trajnime OPP - OSBE
- Takime komitete Rajonale
- Trajnime komitete Rajonale
- Aktorë të vijës së parë
- Nxënës dhe të rinj
- Komunitetet fetare
- Takime dhe Trajnime KVSP